



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3891/19 prot.

Pogradec, më 20, 09, 2024

Lënda: Dërgohet materiali për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Zonja Kryetare,

Në përfundim të procesit të konsultimit të realizuar me subjektet dhe bizneset që ushtrojnë veprimtari në Zona e Stadiumit, bashkëngjitur po Ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për: *"Përcaktimin e destinacionit të përdorimit, të sipërfaqes truall të shpronësuar nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh blloku te Stadiumi", Pogradec"*.

Me respekt,

KRYETARI
Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy).

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 3 (Tre)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2024

PËR

PËRCAKTIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT, TË SIPËRFAQES TRUALL TË SHPRONËSUAR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM RRUGËSH BLOKU TE STADIUMI”, POGRADEC.

Në mbështetje të; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjave "e", "k" dhe "n" të nenit 54, shkronjës "c" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikat 1 shkronjat "e", "f", pika 8 shkronja "a", pika 9, të nenit 7, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI, neni 801 e vijues të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 300, datë 11.5.2022, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi", Pogradec, pikat 1 dhe 2 të Kreut I, pika 1 shkronja "ç" e Kreut II, pika 2 e Kreut III, Aneksi C, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore", të ndryshuar, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shtetërore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 111, datë 21.10.2022 "Për themelimin e shoqërisë "Pogradeci Invest Shpk" dhe miratimin e aktit të themelimit dhe statutit", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të përcaktojë destinacionin e përdorimit, të sipërfaqes truall të shpronësuar nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh blloku te Stadiumi”, Pogradec, duke miratuar rregulla dhe kritere, të detajuara si më poshtë vijon:
 - 1.1 Nga sipërfaqja totale e truallit 233.7 m2, të përdorej për parkim me pagesë sipërfaqja 133.7 m2 dhe sipërfaqja e mbetur prej 100 m2, të përdorej parkim për rezidentët ose për subjektet tregtare.
 - 1.2 Administrimi i truallit me sipërfaqe 133.7 m2, i destinuar për parkim me pagesë do të administrohet nga, POGRADECI INVEST SHPK, e cila është shoqëri në pronësi dhe pronar të vetëm Bashkia Pogradec.
 - 1.3 Sipërfaqja truall 100 m2, e destinuar që të përdorej parkim për rezidentët ose për subjektet tregtare, të jepej me qira ose me enfiteozë, me procedurë konkurrim të hapur, në përputhje me dispozitat e Kreut II të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar.
 - 1.3.1 Tarifa dysheme e qirasë mujore me të cilën do të fillojë procedura e konkurimit të jetë 20 lek/m2, sipas Aneksit C të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kritereve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", i shtuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 2.9.2020.
 - 1.3.2 Të autorizohet Kryetari i Bashkisë, për lidhjen e kontratës së qerasë.
 - 1.3.3 Kontrata e qirasë të jetë me afat maksimal 20 vjet.
2. Ndarja e sipërfaqjeve sipas destinacionit të përdorimit, do të përcaktohej sipas genplanit bashkëngjitur dhe pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Efektet: Në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave për rregullimin e qarkullimit dhe parkimeve në qendrat e banuara.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Administrata e Bashkisë Pogradec dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuara, Pogradeci Invest.
5. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.
6. U shpall sot më datë _____.____.2024.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



KRGJSH | 555943.120, 4829874.080

20 m

Legjenda e shtrësive

6/2

VENDIM
Nr. 300, datë 11.5.2022



PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM RRUGËSH, BLOKU TE STADIUMI”, POGRADEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Sistemim rrugësh, blloku te stadiumi”, Pogradec.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Pogradec.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë 23 004 584.25 (njëzet e tre milionë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet e pesë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 23 004 584.25 lekë (njëzet e tre milionë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër pikë njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit në Bashkinë Pogradec.

8. Bashkia Pogradec kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Pogradec.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, në bashkëpunim me Bashkinë Pogradec, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, fillon procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Pogradec, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRNËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTI
 "SISTEMIM RRUGËSH, BLOKU TE STADIUMI", POGRADEC

Nr.	Emri	Adresa	Mbrojtja	Z.K	Numri i Pasuritë	Sip. total	Sip. e. shprehur	Lloji i pasurisë	Ndërtim		Tabe tmuall		Vlera totale në lek	Konfirmime me abetere nga ZVRRP nr. 2155, datë 17.4.2018	Shënime
									Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek	Çmimi në lek/m ²	Vlera në lek			
1	Thoma	Mhallaq	Narço	8881	1/338	406,76	23,39	Tmuall			245,384,49	245,384,49			
	Leonard	Mhallaq	Narço												
	Tefa	Kopi	Hëca												
	Dhimitra	Kopi	Spro												
2	Ijazi	Dhimiter	Bilazhde	8881	1/80	1261	86,37	Tmuall			906,107,67	906,107,67			Bashkëpronatë Bilazhde ndodhen në pronësi të bashkëpronarëve ASHK Pogradec
	Margari	Dhimiter	Bilazhde												
	Brenilda	Gjergji	Bilazhde												
3	Vllazëria	—	Gumbulli	8881	1/443	508	322,27	Tmuall			3.380,954,57	3.380,954,57			
	Jordan	Ismail	Vakov												
4	Dina	Ismail	Vakov	8881	1/725	110	110	Tmuall			1.154,010,00	1.154,010,00			
	Adim	Asis	Dervishllari												
5	Mirrever	Asis	Dervishllari	8881	2/134	22,5	22,5	Tmuall			236,047,50	236,047,50			
	Safije	Asis	Dervishllari												
	Nazime	Asis	Dervishllari												
	Genç	Reiz	Dervishllari												
	Leonat		Dervishllari												
			Dervishllari												
6	Nazime	Asis	Dervishllari	8881	2/132	114	114	Tmuall			1.195,974,00	1.195,974,00			
	Mirrever	Asis	Dervishllari												
8	Grup	Nouf	Dhollari	8881	2/333	224	224	Tmuall			2.249,984,00	2.249,984,00			Kufizim sekstioni E
	Rehëp	Nouf	Dhollari												
	Flanorje	Nouf	Dhollari												
	Mysafere	Nouf	Dhollari												
9	Dhuanan	Nebi	Mallëlan	8881	6/388	993	63,96	Tmuall			671,004,36	671,004,36			
	Çuric	Myfit	Mallëlan												
	Lumnuze	Myfit	Mallëlan												
	Bajram	Myfit	Mallëlan												
	Hyren	Server	Mëmëulli (B)												
Ikbal		Myfitu													
Anastas (Abie)		Myfitu (Ave)													
Nervat		Mmarulli													





10	Famëz		Minaeoll		8881	2/135	120	48.2	13.67	Trrall	45216	2,179,411.20	143,411.97	143,411.97	Kufizim rekloni E
	Adelina	Nexhip	Minaeoll	Minaeoll											
11	Soemq	Kelji	Angjellari	Yesho	8881	1/81+2-1	48.2	48.2	13.67	Trrall	45216	2,179,411.20	143,411.97	143,411.97	Kufizim rekloni E
	Abdsonder	Ezver	Yesho	Yesho											
12	Zana	Qetim	Yesho	Yesho	8881	1/81+2-1	48.2	48.2	13.67	Trrall	45216	2,179,411.20	143,411.97	143,411.97	Kufizim rekloni E
	Perit	Demir	Rushit	Rushit											
13	Lumnuqje	Jashar	Rushit	Rushit	8881	1/81+3-1	40	40	40	Apartment	45216	1,808,640.00	1,808,640	1,808,640	Kufizim rekloni E
	Geni	Perit	Rushit	Rushit											
14	Gurije	Xhevahir	Elmas	Elmas	8881	1/81+4-1	25	25	25	Apartment	45216	1,130,400.00	1,130,400.00	1,130,400.00	Kufizim rekloni E
	Nevrus	Xhevahir	Elmas	Elmas											
15	Elza	Shaban	Kuri	Kuri	8881	1/81+6-1	27.5	27.5	27.5	Apartment	45216	1,234,306.80	1,234,306.80	1,234,306.80	Kufizim rekloni E
	Ferdine	Ismail	Rapollari	Rapollari											
16	Levndha	Nevrus	Bredellari	Bredellari	8881	1/81+1-1	25.5	25.5	25.5	Apartment	45216	1,153,008.00	1,153,008.00	1,153,008.00	Kufizim rekloni E
	Liljana	Fuat	Bredellari	Bredellari											
Totall i aprovonemnit															
											12,437,608.08	23,004,584.25	23,004,584.25		


Shënime:

Gjimi për pasuritë "mull" është marrë sipas V.N.V. nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e burime të shtesë të shtetit në Republikën e Shqipërisë".

Gjimi për pasuritë "apartment" është marrë nga mesazhi e shprehjes nr. 3 muajve të fundit nga Z.V.R.P.P.-ja, me shkresën nr. 2135, datë 17.4.2018.

Informacioni për pasuritë e mësipërme është marrë nga Z.V.R.P.P. Pogradec.







REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 389/1 Prot.

Pogradec, më 20.09.2024

RELACION
PËR PROJEKT- VENDIMIN

PËR
PËRCAKTIMIN E DESTINACIONIT TË PËRDORIMIT, TË SIPËRFAQES
TRUALL TË SHPRONËSUAR NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "SISTEMIM
RRUGËSH BLOKU TE STADIUMI", POGRADEC.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARË !

Në Fletoren Zyrtare, Nr. 72, datë 13.05.2022, është publikuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. Nr. 300, datë 11.5.2022, "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh, blloku te Stadiumi", Pogradec", dhe ka për objekt, shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Sistemim rrugësh, blloku te stadiumi", Pogradec.

Shpronësimi do të realizohet në favor të Bashkisë Pogradec dhe pronarët e pasurive të paluajtshme, që preken nga ky shpronësim, do të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur vendimit.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, që rrjedhin nga zbatimi i V.K.M-së, së sipërcituar nga ana e administratës së Bashkisë Pogradec, janë kryer të gjitha procedurat përkatëse, si më poshtë vijon:

1. Është realizuar procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale.
2. Janë kryer të gjitha procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
3. Në përfundim të procesit të likuidimit është realizuar kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Pogradec.



Aktualisht, ndodhemi në situatën kur do të fillojë procesi i prishjeve të banesave të amortizuara të cilat ndodhen tek sheshi prapa Pallatit të Sportit, "Arefi Berberi", Pogradec dhe objekt shpronësimi, dhe si administratë, në përmbushje të detyrimeve ligjore, do të ndodhemi përballë një problemi për të disiplinuar hapësirën truall të lirë krijuar se për çfare do të përdorej.

Administrata e Bashkisë Pogradec, duke marrë në konsideratë faktin që sipërfaqja ku do të realizohej shpronësimi, "truall i lirë, ndodhej në zonë afër liqenit, ku nevoja për parkim sidomos për periudhen e Verës, është relativisht e madhe, si nga ana e parkimit nga turistët por edhe nga subjektet tregtare që ushtrojnë veprimtari në këtë zonë, mendon që kjo sipërfaqe "truall i lirë", të destinohet të përdorej për parkim nga shoqëria me pergjegjesi te kufizuara POGRADECI INVENST SHPK, në pronesi te bashkisë (struktura ne varesi te bashkise) dhe 100 m2 të jepej me qera (sipas procedurave te konkurrimit te percaktuar nga V.K.M –ja 54) tek rezidentet ose tek subjektet tregtare qe ushtrojne veprimtari tregtare.

Eshtë e rëndësishme të theksohej e gjitha procedura per dhenie me qera, do te jete transparente, dhe fitues do të shpallej kush do te permbushe kriteret ligjore dhe paraqet oferte me te larte.

Për sa më sipër referuar; nenit 113 të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", shkronjës "a" të pikës 1.2 të nenit 9, shkronjave "e", "k" dhe "n" të nenit 54, shkronjës "c" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shteterore dhe enteve publike", pikat 1 shkronjat "e", "f", pika 8 shkronja "a", pika 9, të nenit 7, të Ligjit Nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI, neni 801 e vijues të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, pikat 1 dhe 2 të Kreut I, pika 1 shkronja "ç" e Kreut II, pika 2 e Kreut III, Aneksi C, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", të ndryshuar, Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 111, datë 21.10.2022 "Për themelimin e shoqërisë "Pogradeci Invest Shpk", konkludojme se:

1. Eshte e drejta e Këshillit të Bashkisë Pogradec, qe ne cilesine e pronarit te ushtroje tagrat e pronesise, dhe te vendose per dhenien me qera ose enfiteoze te siperfaqes "truall i lire".
2. Me vendim të këshillit të bashkisë, caktohej zona për parkim, në të cilat qëndrimi i mjeteve kushtëzohet nga pagesa e një shume që varet nga kohëzgjatja e qëndrimit, duke fiksuar kushtet dhe tarifat.
3. Në rastin kur bashkia përcakton zona parkimi me pagesë, sipas shkronjës "f" të pikës 1 të këtij neni, administrimi i këtij shërbimi, me vendim të këshillit përkatës, mund të kryhet:

a) drejtpërdrejt nga strukturat e bashkisë përkatëse.

(Ne rastin konkret do të realizohej nga shoqëria në pronësi të bashkisë Pogradec, **POGRADECI INVEST SHPK**).



Bashkëngjitur po Ju dergojme edhe të gjitha dokumentacionin e pronësive në emër të Bashkisë Pogradec.

Për sa më sipër mendojmë se projektvendimi i ri bashkëngjitur është në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

Ju Faleminderit,

PËRGATITI MATERIALIN:

Koneptoi: Nexhmi Torra
Romeo Jajçari

Miratoi: Johan Sterjo

Konfirmoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**

